FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION
Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil: +383 (0) 45 692 329
e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

BULETIN ZYRTAR
ISSF JUNIOR WORLD CHAMPIONSHIP
RIFLE / PISTOL / SHOTGUN
SUHL, GERMANY
16 - 26 JUNE 2026

Pjesëmarrja dhe rezultati i sportistes së Kosovës
Dhurata Ibrahimi
10m Air Rifle Women Junior

1. HYRJE

Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës (FSHSK) u përfaqësua në ISSF Junior World Championship Rifle / Pistol / Shotgun 2026 në Suhl të Gjermanisë nga sportistja Dhurata Ibrahimi, në disiplinën 10m Air Rifle Women Junior. Gara kualifikuese e kësaj disipline u zhvillua më 20 qershor 2026.

2. PËRFAQËSIMI I KOSOVËS

Sportistja	Shteti	Disiplina	Trajneri
Dhurata Ibrahimi	Kosovë (KOS)	10m Air Rifle Women Junior	Tomislav Lazić, prof.

3. REZULTATI ZYRTAR - 10m AIR RIFLE WOMEN JUNIOR

Në kualifikime, Dhurata Ibrahimi realizoi 606.5 rrathë dhe u rendit në vendin e 131-të. Në listën zyrtare të ISSF-së figurojnë gjithsej 141 sportiste.

Sportistja	S1	S2	S3	S4	S5	S6	Totali	Renditja
Dhurata Ibrahimi	100.6	101.7	98.4	101.8	102.3	101.7	606.5	131 / 141

Rezultati total: 606.5 rrathë | Vendi: 131 / 141

4. ANALIZA E SERIVE

Seria	Rezultati	Ndryshimi nga seria paraprake
Seria 1	100.6	
Seria 2	101.7	+1.1
Seria 3	98.4	-3.3
Seria 4	101.8	+3.4
Seria 5	102.3	+0.5
Seria 6	101.7	-0.6

Seria e tretë ishte seria me rezultatin më të ulët, 98.4. Pas saj, sportistja u rikthye me 101.8, 102.3 dhe 101.7 në tri seritë e fundit, duke e përfunduar garën me total 606.5.

5. VLERËSIMI I TRAJNERIT

Sipas raportit të trajnerit Tomislav Lazić, rezultati 606.5 përbën rezultatin e ri më të mirë personal të Dhurata Ibrahimit në garat ndërkombëtare të përmendura në raport. Trajneri thekson se sportistja ishte e fokusuar dhe e përkushtuar, ndërsa pas vështirësive në serinë e tretë arriti ta përfundonte garën në mënyrë të qëndrueshme.

Raporti evidenton gjithashtu nevojën për më shumë ditë stërvitore, veshje të reja të përshtatura për sportisten dhe testim të diabollave. Gjatë kontrollit të pajisjeve u konstatua problem me rripin, ndaj u sigurua një rrip i ri. Sportistja provoi edhe këpucë të reja dhe u zhvillua stërvitje shtesë dry-fire për

përshtatjen me ndryshimet në pajisje.

6. UDHËTIMI DHE ORGANIZIMI

Sipas raportit të trajnerit, udhëtimi për Kampionatin Botëror për Juniorë u realizua në periudhën 18-21 qershor 2026, ndërsa organizimi i plotë i udhëtimit përfshiu nisjen e trajnerit nga Zagrebi, udhëtimin drejt Prishtinës, fluturimin me sportisten drejt Stuttgartit dhe vazhdimin me veturë drejt Suhlit. Pas mbërritjes, pushka dhe pajisjet u dorëzuan në hapësirën e ruajtjes në poligon.

8. PËRMBLEDHJE

Elementi	Të dhënat
Kampionati	ISSF Junior World Championship 2026
Vendi	Suhl, Germany
Disiplina	10m Air Rifle Women Junior
Sportistja	Dhurata Ibrahimi
Rezultati	606.5 rrathë
Renditja	131 / 141

9. PËRFUNDIM

Pjesëmarrja në ISSF Junior World Championship 2026 në Suhl përbën një tjetër paraqitje ndërkombëtare për Dhurata Ibrahimin dhe FSHSK-në. Rezultati 606.5 dhe renditja 131 nga 141 sportiste dokumentohen në rezultatet zyrtare të ISSF-së. Raporti teknik i trajnerit evidenton progresin e sportistes dhe përcakton fushat kryesore për punën e ardhshme: vazhdimësinë e stërvitjes, pajisjet sportive të përshtatshme dhe përgatitjen teknike.

Përgatiti:

Baki Azemi
Sekretar i Përgjithshëm
Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës – FSHSK

Shpërndarja:
1x1 Arkivit.